



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në bazë të nenit 42, 47, 48 dhe 167, të Statuti nr.04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ – së, në mbledhjen e mbajtur më dt. 06.02.2023, miratoj këtë:

RREGULLORE PËR NGARKESËN E PUNËS PËR MËSIMËDHËSIT, BASHKËPUNËTORËT DHE ASISTENTËT NË NJËSITË AKADEMIKE DHE INSTITUTIN E SHKENCËS DHE TË ARTEVE TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i Rregullore ngarkesën e punës për mësime dhënësit, bashkëpunëtorëve, asistentëve dhe korepetitorëve në njësitë akademike dhe Institutin për Shkencë dhe Arte të Universitetit "Haxhi Zeka" (më tej e quajtur Rregullore) është standardizimi i ngarkesës së punës së personelit akademik dhe personelit të Institutit për Shkencë dhe Arte në universitetin "Haxhi Zeka" (më tej UHZ).

Neni 2
Përkufizimet

- ▶ **Orari i punës**, - në kuptim të Ligjit për punë, orari i punës zgjatë 40 orë në javë.¹
- ▶ **Marrëdhënie e punës**, - nënkupton një marrëveshje ose rregullim kontraktual juridik ndërmjet UHZ –së si punëdhënës, në njërin anë, dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të punës, në anën tjetër, kundrejt një pagese të dakorduar në formë të parave.
- ▶ **Kontratë pune**, - është akti individual që lidhet ndërmjet UHZ –së dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet tjera të UHZ –së.
- ▶ **Kurrikula**, përcakton lëndët mësimore, numrin total të orëve të leksioneve, ushtrimeve dhe praktikës profesionale, si dhe mjetet mësimore bazë ose pajisjet e nevojshme për zbatimin e atij plani. Kurrikula përcakton: përmbajtjen e lëndës, mënyrën e mësimeve dhe dhënies së provimeve dhe format e tjera të vlerësimit të njohurive (punime seminarike, prezantime punimesh, kolokiume), si dhe tekste të detyrueshme, manuale dhe literaturë tjetër të detyrueshme në bazë të të cilave. jepet provimi në atë lëndë dhe mjetet bazë mësimore, gjegjësisht pajisjet e nevojshme për realizimin e atij programi, si dhe numri i krediteve ECTS.
- ▶ **Mësimdhënës**, në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohet personi i cili ka një kontratë punë në fushën shkencore – mësimore ose një kontratë punë në fushën e mësimeve me njërin nga njësitë akademike të UHZ –së, me qëllim të zhvillimit të mësimeve në të gjitha nivelet e studimeve;
- ▶ **Mësimdhënës për lëndët teorike kolektive** – në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohet person i cili ka një kontratë pune në fushën e mësimeve së

¹ Ligji i punës, nr. 03/L 2012 neni 20 pika 2 – përcaktimi i orarit të punës,

lëndëve kolektive që në vetvete përfshijnë mësimdhënie teorike dhe analitike të lëndëve me grupe më të mëdha të studentëve .

- ▶ **Mësimdhënësi për lëndë praktike grupore** – në kuptim të kësaj rregullorje konsiderohet personi i cili ka një kontratë pune në mësimdhënie praktike me një grup studentësh në formacione korale,orkestrale apo kamertale, zotërimit të shkathtësive të interpretimit artistik grupor të veprave të kompozitorëve të ndryshëm, njohjes me karakteristikat e stileve muzikore nëpërmjet zhvillimit të tyre historik, njohjes me strukturën dhe formën e veprave muzikore, trajnimit për shfaqje publike në kore, orkestra dhe në ansambël.
- ▶ **Mësimdhënësi për lëndët praktike individuale** , - në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili ka një kontratë pune në fushën e mësimdhënies praktike individuale në sferën e zotërimit të teknikave të instrumentit apo të të kënduarit, zotërimit të shkathtësive të interpretimit artistik të veprave të kompozitorëve të ndryshëm, njohjes me karakteristikat e stileve muzikore nëpërmjet zhvillimit të tyre historik, njohjes me strukturën dhe formën e veprave muzikore, trajnim për shfaqje publike, solist në koncerte.
- ▶ **Asistent**, në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili ka një kontratë pune në fushën shkencore – mësimore ose një kontratë pune në fushën e mësimdhënies në njërin nga njësitë akademike të UHZ –së, me qëllim të zhvillimit të ofrimit të ushtrimeve sipas programeve të akredituara në njësi akademike;
- ▶ **Korepetitor**², në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili ka një kontratë pune në fushën e artit muzikor në kuadër të Fakultetit të Arteve me qëllim të përcjelljes me piano veprat artistike gjatë orëve individuale, ushtrimeve, koncerteve të interpretuesve.
- ▶ **Lektor**³, në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili mban ligjërata (mësimdhënie) në lëndët e gjuhëve të huaja ose edhe në gjuhën shqipe.
- ▶ **Laborant**⁴, në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili merret me punë teknike / ndihmëse në kuadër të aktiviteteve që zhvillohen në laboratorë të cilat i posedojnë njësitë akademike të UHZ –së;
- ▶ **Bashkëpunëtor**, në kuptim të kësaj rregullorjeje konsiderohet personi i cili me njërin nga njësitë akademike të UHZ –së ka të lidhur një kontratë pune për bashkëpunim në mësimdhënie në nivel të studimeve të nivelit të pestë (5) të paraparë me Ligjin për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Republikës së Kosovës, Nivelin e gjashtë (6) dhe nivelin e shtatë (7);
- ▶ **Kompozimi i ngarkesës së punës**, nënkuptohet ndarja e tërësisë së ngarkesës së punës të mësimdhënësit ose bashkëpunëtorit për punë në mësimdhënie, shkencore – kërkimore, kontributin për punë administrative dhe punë të tjera në përputhje me kontratën e punës me UHZ –në;
- ▶ **Kompozimi i planifikuar i ngarkesës së punës**, është kompozimi i ngarkesës së punës të të gjithë mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve në nivel të njësisë akademike;
- ▶ **Aktiviteti mësimor indirekt**, janë aktivitetet e mësimdhënësit, bashkëpunëtorit në mësimdhënie, asistentit ose korepetitorit të cilat nuk janë të përfshira në aktivitete direkte dhe të cilat nuk janë plotësisht të normuara por të cilat është e mundshme të evidentohen në mënyrë të veçantë. Këto janë aktivitete të cilat i takojnë përparimit të aktivitetit mësimor dhe artistik, mbajtjes së mësimin, ushtrimeve dhe

² Korepetitor (në shqip shoqërues) (fjalë latine. repeter: për të përsëritur), në muzikë, një ndihmës dirigjent i një ansambli opere ose baleti, i cili bën prova në pjesët e tyre, apo i shoqëron gjegjësisht ndihmon solistët dhe korin në piano.

³ Mikel Ndreca, Fjalorë fjalësh e shprehjesh të huaja, Botim i Rilindjes 1986 fq. 430

⁴ Po aty fq. 425

punës me studentë (shkrimi të përmbledhjeve dhe detyrave, skriptave, përkthime, leximi dhe vlerësimi i punimeve përfundimtare studimore) të lidhur me provimet pranuese, perfeksionimin e të arriturave mësimore, përpunimin e përmbajtjeve digjitale, kontrollimit të programit dhe praktikave ditore, kujdestarive në provime, etj.

- ▶ **Aktiviteti mësimor direkt**, janë të gjitha aktivitetet direkte të mësimdhënies paradiplomike, diplomike dhe pasdiplomike siç janë: ligjëratat, seminarët, ushtrimet, punët në laboratorë, punët individuale në arte, etj.
- ▶ **Mësimi repetitiv⁵(përsëritje)**, është mësimi të cilin mësimdhënësi ose bashkëpunëtori, më qëllim të të nxënit më të mirë, e realizon në llojin e njëjtë më mësimdhënien (në ligjërata ose ushtrime),
- ▶ **Mësimi me aktivitet ex ante**,⁶ është punë në mësimdhënie e cila i paraprin aktiviteteve mësimdhënëse (p.sh. shembujt për organizimin e lëndës mësimore).
- ▶ **Mësimi me aktivite ex post**,⁷ është puna në mësimdhënie e cila rrjedh pas përfundimit të aktiviteteve mësimore (p.sh. provimet, kolokiumet, konsultimeve, mentorimet, etj.);
- ▶ **Aktivite direkte shkencore – kërkimore**, janë aktivitetet e mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit në fushën e kërkimeve shkencore e cila realizohet me punë direkte në aktivite kompetitive kërkimore – shkencore në sferën e projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe aktiviteve të ngjashme në institute ose fakultete;
- ▶ **Aktivite indirekte shkencore – kërkimore**, janë aktivitetet e mësimdhënësit ose të bashkëpunëtorit shkencor – kërkimor, të cilat i realizon në angazhime dhe aktivite kompetitive indirekte në sferën e projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare duke i përfshirë edhe aktivite e ngjashme në institute ose fakultete (p.sh. punë në zbatimin e projekteve, në redaksinë e revistës dhe redaktimin e punimeve, recensionimin e punimeve shkencore dhe projekteve, punime profesionale si rezultat i kërkimeve në harmoni me misionin e UHZ-së, njësisë akademike ose të institutit);
- ▶ **Kontributi institucional**, përfshinë kontributin e mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit për avancimin e tërësishëm të njësisë akademike në sferën e specializimit ose kërkimeve shkencore me punë në forume, komisione profesionale në nivel institucional, të njësisë akademike ose përfaqësime në Këshillin Drejtues të UHZ –së, Senat, organizimin e konferencave shkencore e profesionale.
- ▶ **Punët administrative**, bashkë më aktivite mësimore dhe shkencore – mësimore të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit të cilat nuk janë të plotësuara me norma por të cilat mund të jenë të evidentuara në mënyrë të veçantë.

⁵ Fjalori i fjalëve të huaja: Botim i Rilindjes vitit 1988, Termi **repetitive** = repetitim, repetoj, repëtor, repëtorium, (fjalë latine *repeater*) nënkupton përsëritjen, përsëris, etj.

⁶ Punë e mësimdhënësve e klasifikuar si ex - ante llogaritet për periudhën e ardhshme. Llogaritja e saj bazohet në kthimet gjegjësisht rezultatet e pritshme. Prandaj, fraza rezultat i pritshëm mund të përdoret gjithashtu. Kthimi i pritshëm zakonisht shprehet në bazë të normës së brendshme të përfitueshmërisë që kanë studentë nga këto aktivite mësimore.

⁷ Puna ex post llogaritet për periudhën e kaluar. Llogaritja e tij bazohet në kthimet e realizuara. Prandaj me togfjalëshin mund të shënohet edhe si rezultat i realizuar.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Ndarja standarde e orarit të punës

Neni 3

Në parim kompozimi i ngarkesës gjatë kohës të orarit të punës për mësimdhënësit/bashkëpunëtorët, asistentët dhe korepetitorët në njësi akademike në përputhje me standardin e ndarjes së këtij orari, paraqet:

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|---|---|
| 1 | Për punë shkencore – mësimore | 45% punë në mësimdhënie |
| | | 45% punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore | 67.5 % në punë më mësimdhënie |
| | | 22.5% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | Për punë mësimore në lëndë teorike kolektive | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 20% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 15% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Për punë mësimore në lëndë praktike grupore | 60 % në punë më mësimdhënie |
| | | 30% në punë kërkimore dhe interpretative |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 5 | Për punë mësimore në lëndë praktike individuale | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 20% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 15% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 6 | Për punë e bashkëpunëtorit në nivelin e studimeve pas doktorantit | 33.8% për punë në mësimdhënie |
| | | 56.2% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 7 | Për punë e bashkëpunëtorit asistent | 22.5% për punë në mësimdhënie |
| | | 67.5% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 8 | Asistentë mësimor | 22.5% për punë në mësimdhënie |
| | | 67.5% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 9 | Korepetitor | 70 % në punë më mësimdhënie |
| | | 25 % paraqitje publike dhe interpretative |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 10 | Lektor | 70 % në punë më mësimdhënie |
| | | 20 % paraqitje publike dhe interpretative |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |

Ndarja fleksibile e orarit të plotë të punës

Neni 4

Shmangia nga standardi i orarit të plotë të punës në raport me fondin standard të orëve të punës për mësim dhe aktivitete shkencore – kërkimore paraqet fleksibilitetin e ndarjes së ngarkesës për orarin e punës në mënyrë që në orarin e plotë të punës mësimdhënësi ose bashkëpunëtori mund t'i zhvillojë si më poshtë për:

1. Vendin e punës për shkencëtar – mësimdhënësi:

- me orar më të paktën 27% e deri në 63% për mësimdhënie, dhe në të njëjtin orar të aktiviteteve shkencore për orare të plotë pune;
2. **Vendin e punës mësimdhënës:**
 - Me orar më të paktën 55% e deri në 90% në mësimdhënie dhe më së shumti deri në 35% në aktivitete shkencore – kërkimore me orar të plotë pune.
 3. **Vendin e punës mësimdhënës në lëndë teorike kolektive:**
 - Me orar të paktën 30% deri në 80% në mësimdhënie dhe më së shumti deri në 50% në punë shkencore – kërkimore me orar të plotë të pune.
 4. **Vendi i punës mësimdhënës për lëndë praktike grupore:**
 - Me orar të paktën 40% deri në 80% punë në mësimdhënie, dhe më së shumti deri në 20% punë shkencore – kërkimore dhe artistike me orar të plotë pune
 5. **Vendi i punës për lëndë praktike individuale:**
 - Me orar të paktën 60% deri në 90% punë në mësimdhënie dhe më së shumti deri në 20% punë kërkimore – shkencore dhe artistike me orar të plotë pune
 6. **Vendin e punës bashkëpunëtor doktorant:**
 - Me orar me të paktën 33.8% e deri në 40% në mësimdhënie dhe më së paku prej 65% e deri 67.5% në shkencë – kërkime për orar të plotë pune.
 7. **Vendin e punës bashkëpunëtor asistent:**
 - Me orar me të paktën 22.5% e deri në 25% në mësimdhënie dhe më së paku 65% e deri më së shumti 67.5% për punë shkencore – kërkimore për orar të plotë pune.
 8. **Vendin e punës asistent mësimor:**
 - Me orar me të paktën 30% e deri në 50% në mësimdhënie dhe deri më së shumti 70% për punë shkencore– kërkimore për orar të plotë pune.
 9. **Vendi i punës korepetitor:**
 - Me orar të paktën 60% deri në 90% punë në mësimdhënie dhe më së shumti deri në 20% punë kërkimore – shkencore dhe artistike me orar të plotë pune;
 10. **Vendi i punës lektor:**
 - Me orar të paktën 60% deri në 90% punë në mësimdhënie dhe më së shumti deri në 20% punë kërkimore – shkencore me orar të plotë pune;

Neni 5

Kushte për shmangje nga standardi i ndarjes së orarit të punës

- 1) Rritja e orarit të punës për shkencë – kërkime në raport me ngarkesën standarde, në frymën e dispozitës së mësipërme, është e mundur në rastet kur mësimdhënësi dhe bashkëpunëtori punojnë në mënyrë kompetitive në aktivitete shkencore – kërkimore ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura për projekte të cilat kërkojnë tejkalim të orarit të punës për dallim nga standardi i ndarjes së orarit të punës;
- 2) Rritja e orarit të punës për mësimdhënie në raport me ngarkesën standarde, në frymën e dispozitës së mësipërme, mund të përshtatet sipas programit dhe nevojave të njësisë akademike.

Neni 6
Ndarja reale e orarit të plotë të punës

- 1) Planifikimi i përbërjes së orarit të plotë të punës i të gjithë mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve përcaktohet dhe vërtetohet me planin vjetor të njësisë akademike dhe me miratimin e Dekanit, para fillimit të vitit akademik, në periudhë për një vit akademik.
- 2) Vendimi i dekanit sipas pikës së sipërshënuar, si tërësi nxirret mbi bazën e nevojave të njësisë akademike, eventualisht në pajtim me preferencat e mësimitdhënësve/ bashkëpunëtorëve.

PUNA NË MËSIMDHËNIE

Neni 7

- 1) Puna në mësimitdhënie e mësimitdhënësve dhe e bashkëpunëtorëve ndahet në bazë të aktiviteteve mësimore direkte dhe indirekte;
- 2) Punët direkte në mësimitdhënie janë:
 - a) Të gjitha format e aktiviteteve të drejtpërdrejta të udhëheqjes së punëve para diplomike, diplomike dhe pas diplomike; ligjëratat, seminare, ushtrime dhe punë laboratorike, punë në terren, etj.,
 - b) Përgatitjet për mësimitdhënie dhe në këtë funksion edhe organizimi i punës me bashkëpunëtorë të lëndës;
 - c) Punët të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e ngarkesës mësimore (provime, kolokfiume, punime seminarike, etj),.
 - d) Punët për mentorime në kuadër të punës vetanake të studentit (punime përfundimtare, tema diplome, mentorime në master e doktoratë) etj;
- 3) Punët indirekte në mësimitdhënie janë:
 - a) Punët tjera të lidhura me aktivitetet mësimore janë:
 - *Veprimtaria në kuadër të komisioneve të ndryshme profesionale (mbrojtja dhe vlerësimi i punimeve në të gjitha fazat e studimeve)*
 - *Përsosshmëria në të arriturat mësimore;*
 - *rishikimi i programit dhe punës praktike;*
 - *Kujdestaria në provime, etj.*
 - b) Shkrimi, regullimi dhe recensimi i teksteve, skripteve, përmbledhjeve të detyrave, etj.,
- 4) Në rastet kur mësimitdhënësi / bashkëpunëtori jep mësim në ndonjë institucion tjetër jashtë UHZ –së atëherë kjo nuk i numërohet në ngarkesën e orarit të njësisë akademike;
- 5) Përrjashtimisht, nëse mësimitdhënësi / bashkëpunëtori mban mësim në ndonjë njësi akademike të ndonjë universitetit tjetër në Kosovë, atëherë ky angazhim i llogaritet vetëm nëse ky angazhim ka qenë i regulluar me ndonjë akt të nënshkruar ndëruniversitar lidhur me projekte dhe programe të përbashkëta.

Neni 8

- 1) Ngarkesa mësimore e mësimitdhënësit i cili kryen detyrën e rektorit ka 20% të ngarkesës së plotë të mësimitdhënies;
- 2) Ngarkesa mësimore e mësimitdhënësit i cili kryen detyrën e prorektorit ka 20% të ngarkesës së plotë të mësimitdhënies;
- 3) Ngarkesa mësimore e mësimitdhënësit i cili kryen detyrën e prorektorit ka 20% të ngarkesës së plotë të mësimitdhënies;

- 4) Ngarkesa mësimore e mësimdhënësit i cili kryen detyrën e dekanit ka 20% të ngarkesës së plotë të mësimdhënies;
- 5) Ngarkesa mësimore e mësimdhënësit i cili kryen detyrën e prodekanit ka 50% të ngarkesës së plotë të mësimdhënies;
- 6) Ngarkesa mësimore e mësimdhënësit i cili është i punësuar me procedurë të veçantë dhe më kohë të pjesshme, koha e ngarkesës mësimore i përcaktohet me kontratën e punës;
- 7) Ngarkesa mësimore e mësimdhënësit i cili kryen detyrën e anëtarit të KD-së, të zgjedhur nga Senati, ka 10% të ngarkesës së plotë të mësimdhënies;

Matja standarde e disa formave të mësimi direkt

Neni 9

- 1) Orët standarde ekuivalente të duhura për një (1) orë kontakti në kuadër të orarit të rregullt të punës, duke përfshirë edhe aktivitetet direkte mësimore të cilat futen në pjesën e tërësishme të orarit të punës mësimore, përbëjnë:
 - a) Në ligjërata 4 – 6 orë pune;
 - b) Në seminare 4 orë pune;
 - c) Në ushtrime 2.7 orë punë;
 - d) Në ligjërata në studime pas diplomike 8.1 orë pune
- 2) Orët standarde ekuivalente të duhura për një (1) orë kontakti në kuadër të orarit të rregullt të punës për aktivitete indirekte, përbëjnë:
 - a) Në ligjërata 3.2 orë punë;
 - b) Në seminare 2.4 orë punë;
 - c) Në ushtrime 1.6 orë punë;
 - d) Në ligjërata në studime pas diplomike 4.9 orë pune.

Neni 10

- 1) Aktivitet e matshme mësimore ndahen në:
 - Ex ante aktivitete të matshme mësimore (p.sh. përgatitjet për mësimi dhe organizimin e mësimi dhe programit, etj).
 - Aktivitete indirekte mësimore;
 - Ex post punë të matshme mësimore (p.sh. provimet, kolokfiumet, konsultimet, mentorimet, etj).
- 2) Orët standarde ekuivalente të nevojshme për një (1) orë kontakti në ex ante në matjen e aktiviteteve mësimore, përmban:
 - a) Në ligjërata 1 orë punë;
 - b) Në seminare 0.7 orë pune;
 - c) Në ushtrime 0.3 orë pune;
 - d) Në ligjërata në studime pas diplomike 1.4 orë punë;
- 3) Orët standarde ekuivalente të nevojshme për një (1) orë kontakti në ex post matje për aktivitete mësimore, përmban:
 - a) Në ligjërata 1.2 orë punë;
 - b) Në seminare 0.7 orë punë;
 - c) Në ushtrime 0.3 orë punë; dhe
 - d) Në ligjërata në studime pas diplomike 2.5 orë punë.

Neni 11

- 1) Aktivitet ex post të matshme mësimore (p.sh. provimet, testet, kolokfiumet, konsultimet, mentorimet, etj) evidentohen nëpërmjet formimit të dy llojeve aktiviteteve të matshme ex post, me qëllim të përcjelljes së orëve të nevojshme të dedikuara për aktivitete ex post të matshme mësimore, si më poshtë:

- Aktivitetet Ex post të matshme mësimore për vërtetimin e njohurive (p.sh. testeve, kolokfumeve, provimeve, etj);
 - Aktivitete të matshme mësimore ex post të lidhura për mentorime (p.sh. punime përfundimtare, projekte profesionale, punime kërkimore – shkencore, punime diplome, konsultime, etj);
- 2) Evidenca e aktiviteteve të matshme mësimore ex post realizohet në këto mënyra:
- a) Orët ekuivalente të nevojshme të përcaktuara në ex post për aktivitetet e matshme sipas tërësisë së numrit të orëve në njësi akademike ndahen në:
 - 50% për aktivitete mësimore ex post të lidhura me verifikimin e njohurive (p.sh. testet, kolokfiumet, provimet, etj);
 - 50% për aktivitet mësimore ex post të lidhura me mentorime (p.sh. punime përfundimtare, projekte profesionale, punime kërkimore – shkencore, punime diplome, etj)
 - b) Numri i orëve të punës për ex post të lidhura me aktivitetet mësimore për vërtetimin e njohurive në njësi akademike ndahen më numrin e përgjithshëm të studentëve nëpër lëndë dhe nëpër fakultete derisa të fitohet ngarkesa normative ex post e aktiviteteve të matshme mësimore, të lidhura me verifikimin e njohurive për student;
 - c) Evidenca ex post e aktiviteteve mësimore të lidhura për mentorimet realizohet në atë mënyrë që tërësia e numrit të orëve ex post për aktivitete mësimore të lidhura për mentorimin në njësi të ndryshme akademike i përshtatet numrit të orëve të të gjitha llojeve të aktiviteteve me të cilat mentorohen në njësi akademike, e para së gjithash duke i vlerësuar raportet në mes të llojeve të aktiviteteve:

| Nr | Përmbajtja | Orët |
|----|--|--|
| 1 | Praktika profesionale | 0.5 |
| 2 | Projektet zyrtare | 1 |
| 3 | Puna kërkimore shkencore I | 1 |
| 4 | Puna profesionale | 1 |
| 5 | Punimi përfundimtar (para diplomik) | 2 |
| 6 | Punimi përfundimtar dhe provimi (specializimi) | 3 |
| 7 | Puna praktike | 3.5 |
| 8 | Puna kërkimore shkencore II (punimi i diplomës, provimi ui diplomës) | 5.5 |
| 9 | Punimi përfundimtar i studimeve pas diplomike dhe studimeve të specializuara | 22 (zakonisht ndahet në kuadër të dy viteve akademike) |
| 10 | Punimi i doktoratës | 49.9 (zakonisht ndahet në kuadër të tri viteve akademike) |

- 3) Pas evidentimit të të gjitha llojeve të aktiviteteve të matshme ex post, numrit ex post për orë të aktiviteteve të matshme të lidhura me mentorimet për një mësimdhënës dhe për bashkëpunëtorë llogaritet në këtë mënyrë:
 - Për secilin mësimdhënës ose bashkëpunëtorë sipas numrit të kontakteve në orë të ligjëratave dhe ushtrimeve për aktivitete të drekte mësimore

ex post;

- Në mënyrë që të fitohet numri i tërësishëm i orëve ex post i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të lidhura me vërtetimin e njohurive të fituara për student, shumëzohet me numrin e studentëve të cilët mësimdhënësi / bashkëpunëtori e realizon procesin mësimor, dhe shumëzohet me pjesën e ngarkesës së mësimdhënësit / bashkëpunëtorit me vërtetimin e njohurive për ndonjë lëndë;
- Numri i orëve indirekte ex post për aktivitete mësimore të lidhura për mentorimin llogaritet në mënyrë që nga tërësia e orëve për ex post aktivitete indirekte mësimore të mësimdhënësit / bashkëpunëtorit merret numri i orëve për ex post të aktiviteteve mësimore indirekte të lidhura me vërtetimin e njohurive;
- Nëse kjo matje në mes orëve të nevojshme për lloje të ndryshme të ex post aktiviteteve mësimore indirekte është me e madhe se 4:1 për një mësimdhënës / bashkëpunëtor, atëherë realizohet korrektimi i orëve në atë mënyrë që numri i orëve ex post për aktiviteteve mësimore indirekte të lidhura për mentorimin korrigohet në 20% të numrit të orëve të punës për ex post aktiviteteve indirekte mësimore (nëse numri i orëve për ex post aktiviteteve mësimore janë të lidhura me mentorimi është me e vogël se 20% e numrit të orëve ex post të aktiviteteve indirekte mësimore), respektivisht, korrigohet në 80% të numrit të orëve të punës për ex post aktivitete mësimore (nëse numri i orëve për ex post aktivitete mësimore indirekte të lidhura për mentorimet është më i madh se 80% të numrit të orëve të punës për ex post aktivitete indirekte mësimore).
- Përfundim nga ndarja e pikës së sipërshënuar janë vendet e punës të bashkëpunëtorëve dhe ato vende të punës të cilat nuk janë të parashikuara për aktivitete të mentorimit dhe i tërë fondi i ex post aktiviteteve indirekte mësimore për orë punë shpërndahet në pjesën për verifikimi e njohurive.

AKTIVITETI NË PUNË KËRKIMORE – SHKENCORE

Neni 12

- 1) Puna në kërkime shkencore e personelit mësimdhënës / bashkëpunëtorë në kuadër të fondit të përgjithshëm të orëve të punës është:
 - Aktiviteti direkt në punë shkencore
 - Aktiviteti indirekt në punë shkencore
- 2) Aktivitete direkte shkencore janë punë kërkimore – shkencore në fushën e zotërimit të publikimeve të punimeve nëpërmjet projekteve kompetitive kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhura me njësinë akademike dhe me universitetin në përgjithësi;
- 3) Aktivitetet indirekte shkencore janë:
 - Punët në përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve;
 - Punët në redaksinë e revistave kërkimore – shkencore ose punët në pjesë të caktuara (p.sh. editoriale, borde, etj), recensione.
- 4) Puna e mësimdhënësve/ bashkëpunëtorëve në projekte kompetitive shkencore në të cilat njësinë akademike, Instituti dhe universiteti nuk është as bartës e as partner nuk konsiderohet punë në kuadër të ngarkesës të tyre në kuadër të evidencës ku duhet të evidentohen aktivitetet.
- 5) Përfundimisht, puna e theksuar në pikën e mësipërme, mund të konsiderohet

punë në kuadër të ngarkesës së mësimdhënësit/bashkëpunëtorit në njësi akademike, me kusht që të ketë pajtimin ose autorizimin e dekanit të asaj njësie akademike për angazhim në kuadër të projekteve shkencore kompetitive në institucione tjera. Kjo pjesë e caktuar e orëve të punës të cilat mësimdhënësi/bashkëpunëtori i ka realizuar si më sipër bëjnë pjesë në tërësinë e ngarkesës të orarit të punës, në pjesën e aktiviteteve shkencore dhe kjo më kusht që i njëjti të mos pranojë shpërblim për punën e kryer në institucion tjetër jashtë pjesës së pagës së rregullt, dhe në cilësinë e drejtuesit të projektit të një institucioni tjetër dhe të mos i evidentojë si aktivitete të tij në kuadër të fondit për orët punës të përcaktuara në marrëveshje ose me autorizim të dekanit.

Aktivite direkte shkencore

Neni 13

- 1) Forma bazë e organizimit të aktiviteteve direkte shkencore janë projektet kërkimore – shkencore;
- 2) Karakteristikat bazë të projektit kërkimor – shkencor duhet të kenë për qëllim kryesor përcaktimin e qëllimit përfundimtar të projektit, buxhetin, burimet njerëzore dhe materiale, dhe planin (afatet) kohor;
- 3) Secili mësimdhënës dhe bashkëpunëtor duhet të jetë i përfshirë në së paku një nga projektet kërkimore – shkencore;
- 4) Puna në projektin kërkimor – shkencor duhet të jetë e përcaktuar nga ana e dekanit të njësisë akademike me arsyetimin për nevojën e angazhimit dhe në interes të njësisë akademike të UHZ – së dhe me përcaktimin e orëve të nevojshme për të përfunduar projektin;
- 5) Projekti kompetitiv kërkimor – shkencor si në nivel kombëtar po ashtu edhe në atë ndërkombëtar konsiderohet ai i cili fitohet në kuadër të thirrjeve, tenderëve, fondacioneve ose konkurseve. Këto projekte mund të jenë të lidhura me Komisionin Evropian, institucionet të administratës shtetërore ose persona tjerë juridikë vendor ose të jashtëm të cilat kanë kaluar recensionin e duhur (të të njëjtit nivel të vlefshmërisë) qëllimi i të cilave është arritja e njohurie të reja;
- 6) Puna në projekte kërkimore – shkencore mund të arsyetohet edhe me pjesëmarrje në projekte të caktuara kërkimore – shkencore të institucionit, njësisë akademike (projekte të institutit) nëse të njëjtët ekzistojnë;
- 7) Projektet kërkimore – shkencore të njësisë akademike (ose të Institutit) mund të rregullohen edhe me rregullore të veçantë;
- 8) Përrjashtimisht, puna në projekte kërkimore – shkencore mund të arsyetohet edhe me aktivitete të tjera kërkimore – shkencore të cilat kanë karakteristikat bazë të ndonjë projekti kërkimor – shkencor (të kenë qëllimin përfundimtar, aktivitetet, buxhetin, burimet materiale dhe njerëzore dhe planin e afateve kohore) në kuadër të së cilit është e përcaktuar numri i orëve të punës për realizimin e qëllimeve të projektit i cili duhet të jetë i përcaktuar nga ana e dekanit ose nga personeli i autorizuar;
- 9) Orët e nevojshëm standarde ekuivalente për punë në shkencë të cilat arsyetohen me pjesëmarrjen e në projekte të përmendura në pikën 5 dhe 7 të kësaj dispozite, në kuadër të orarit të punës, duke i përfshirë edhe aktivitete indirekte të cilat mbështesin punën në shkencë, duhet të jenë të përshtatura me përqindjet (%) në dispozitat e neneve 3, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

- 1) Planifikimi i orëve të punës në të gjitha aktivitetet dhe llojet e projekteve kërkimore – shkencore të mësimdhënësve / bashkëpunëtorëve, si rregull

- realizohet në fillim të vitit akademik ndërkaq llogaritja përfundimtare realizohet në fund të vitit akademik;
- 2) Planifikimi i numrit të orëve të punës propozohet nga udhëheqësi i projektit dhe lejohet dhe miratohet me vendim të shkruar nga dekani;

Neni 15

- 1) Në rast të pjesëmarrjes në më shumë projekte, planifikimi kumulativ duhet të jetë në përputhje me dispozitat e theksuara në nenet 3, 5 dhe 6.

KONTRIBUTI NË INSTITUCION DHE PUNË ADMINISTRATIVE

Neni 16

- 1) Kontributi në institucion dhe në punë administrative i mësimeve / bashkëpunëtorit, përfshin:
- Punë në senat;
 - Punë në Këshillin e fakultetit;
 - Punë në organe të tjera të njësisë akademike dhe universitetit;
 - Punë në organe / komisione të njësisë akademike dhe të universitetit;
 - Punë në trupa / grupe të përhershme punuese të njësisë akademike ose të universitetit të cilat janë të përshkruara në Statutin e UHZ –së (Komisione për çështje statutare, komisione për çështje të parashtrësive dhe ankesave të studentëve, komisione për çështje të botimeve, komisione për çështje etike, Komisione për çështjet e studimeve tërë jetësore dhe studimet për të rriturit, komisione për vërtetimin e faktit të shkeljeve të lehta ose të rënda të të punësuarve në procedurën disiplinore në kuadër të marrëdhënies së punës, Komisione për dhënien e çmimeve dhe shpërblimeve, Komisione për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të studentëve, Komisione për regjistrim dhe për transfer të studentëve nga institucionet tjera të arsimit të lartë, Këshillin për sigurimi e cilësisë, Komisione për vlerësimin e sistemit të cilësisë së brendshme, Këshillin botues apo komisioni të tjera të parapara me statut dhe rregullore të brendshme të UHZ-së.
 - Puna në trupa / grupe dhe komisione të cilat draftojnë akte dhe rregulla ligjore të njësisë akademike dhe të UHZ –së (manualin ECTS, komisionin për sigurimin e integritetit akademik, komisionin e brendshëm për paraqitjen e parregullsive, komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, etj.
 - Puna e besuar në komisione në kuadër të trupave / grupeve punuese të Universitetit dhe njësisë akademike, etj;
 - Pjesëmarrje në organizimin e konferencave kërkimore – shkencore dhe profesionale të organizuara nga njësi akademike apo universiteti si dhe në rregullimin dhe botimin e revistave botues i të cilave është njësi akademike ose universiteti;
 - Pjesëmarrje në punët profesionale të njësisë akademike;
 - Pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme të cilat paraqesin kontribut institucional për njësi akademike dhe universitetin të caktuar më vendimin e dekanit;
- 2) Planin e ngarkesës në punë për kontributin institucional dhe angazhime administrative për secilin individ mësimeve/bashkëpunëtorë duhet të jetë i vërtetueshëm në formën e shkruar me vendim të dekanit dhe më propozim të udhëheqësit të katedrës – departamentit.
- 3) Plani për pikën e sipërshtuar është i mundshëm të ndryshohet e të

plotësohet gjatë vitit akademik duke i marrë parasysh mundësitë dhe nevojat e njësisë akademike dhe universitetit në tërësi.

Neni 17

- 1) Për qëllime të vërtetimit të punës të realizuara jashtë orarit të punës të mësimdhënësit/bashkëpunëtorit, llogaritja e një angazhimi të fillë realizohet në fund të vitit akademik. Në mënyrë që ky angazhim të konsiderohet si punë jashtë orarit, duhet të bëhet llogaritja e tërësisë së orëve jashtë orarit dhe të matet me sasinë e orëve të rregullta të punës në mësimdhënie dhe në shkencë dhe dallimi të rezultojë si orë shtesë më e madhe se fondi i tërësisë së orëve në punën e rregullt.
- 2) Puna e mësimdhënësit/ bashkëpunëtorit në mësimdhënie dhe shkencë duhet të jetë e evidentuar në përputhe Ligjin e Punës, kontratën e punës dhe me Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.
- 3) Paga për punë jashtë orarit të punës në mësimdhënie ose në shkencë rregullohet me rregullore të veçantë.

DISPOZITAT E VEÇANTA

Ngarkesa në Fakultetin e Biznesit

Neni 18

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|---|---|
| 1 | Për punë shkencore – mësimore | 50% punë në mësimdhënie |
| | | 45% punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 25% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | Për punë e bashkëpunëtorit në nivelin e studimeve pas doktorantit | 35% për punë në mësimdhënie |
| | | 55% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Për punë e bashkëpunëtorit asistentë | 25% për punë në mësimdhënie |
| | | 65% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 5 | Asistentë mësimor | 30% për punë në mësimdhënie |
| | | 60% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |

Tabela e ngarkesës në Fakultetin Juridik

Neni 19

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|---|---|
| 1 | Për punë shkencore – mësimore | 55% punë në mësimdhënie |
| | | 35% punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 25% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | Për punë e bashkëpunëtorit në nivelin e studimeve pas doktorantit | 30% për punë në mësimdhënie |
| | | 60% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Për punë e bashkëpunëtorit | 35% për punë në mësimdhënie |

| | | |
|---|-------------------|--|
| | asistentë | 55% për punë shkencore – kërkimore 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 5 | Asistentë mësimor | 30% për punë në mësimdhënie 60% për punë shkencore – kërkimore 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |

**Tabela e ngarkesës në Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelarisë dhe Mjedisit
Neni 20**

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|--|---|
| 1 | Për punë shkencore – mësimore | 50% punë në mësimdhënie |
| | | 45% punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore | 66.5% në punë mësimdhënie |
| | | 23.5% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | <i>Për punë e bashkëpunëtorit në nivelin e studimeve pas doktorantit</i> | 40% për punë në mësimdhënie |
| | | 50% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Për punë e bashkëpunëtorit asistentë | 35% për punë në mësimdhënie |
| | | 55% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 5 | Asistentë mësimor | 30% për punë në mësimdhënie |
| | | 60% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |

**Tabela e ngarkesës në Fakultetin e Agro-biznesit
Neni 21**

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|--|---|
| 1 | Për punë shkencore – mësimore | 45% punë në mësimdhënie |
| | | 50% punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore | 55.0% në punë mësimdhënie |
| | | 40.0% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | <i>Për punë e bashkëpunëtorit në nivelin e studimeve pas doktorantit</i> | 35% për punë në mësimdhënie |
| | | 55% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 10% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Për punë e bashkëpunëtorit asistentë | 38% për punë në mësimdhënie |
| | | 57% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 5 | Asistentë mësimor | 35% për punë në mësimdhënie |
| | | 60% për punë shkencore – kërkimore |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |

**Tabela e ngarkesës në Fakultetin e Arteve
Neni 22**

| Nr. | Përmbajtja | Ngarkesa në përqindje (%) |
|-----|---|---|
| 1 | Për punë mësimore në lëndë teorike kolektive | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 20% në punë shkencore – kërkimore |
| | | 15% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 2 | Për punë mësimore në lëndë praktike grupore | 65 % në punë më mësimdhënie |
| | | 30% në punë kërkimore dhe interpretative |
| | | 15% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 3 | Për punë mësimore në lëndë praktike individuale | 55 % në punë më mësimdhënie |
| | | 30% në punë kërkimore dhe interpretative |
| | | 15% kontribute në institucion dhe punë administrative |
| 4 | Korrepetitor | 70 % në punë më mësimdhënie |
| | | 25 % paraqitje publike dhe interpretative |
| | | 5% kontribute në institucion dhe punë administrative |

**Dispozitat përfundimtare
Neni XX**

- 1) Dispozitat e veçanta të paraqitura në tabele mund të jenë subjekt i rishikimeve për çdo vit akademik dhe atë sipas nevojave dhe specifikave që i kanë njësitë akademike.
- 2) Ndryshimet që njësia akademike ka nevojë t'i realizojë, të paraqitura në tabele, duhet të miratohen nga Senati i UHZ –së më në largu deri me 15 shtator të vitit vijues.
- 3) Tabela si në pikën 1 dhe 2 të kësaj dispozite, pas miratimit të Senatit, është amendament i kësaj rregullorjeje.
- 4) Kjo rregullore hynë në fuqi ditën kur të miratohet nga Senati i Universitetit "Haxhi Zeka.

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat të UHZ-së.

Kryesuesi i Senatit të Universitetit "Haxhi Zeka"
Prof. dr. Armand Krasniqi



[1] Ligji i punes, n. 03/L 2012 neni 20 pika 2 – percaktimi I orëve të punës

[2] Korepetitor (Albanian: accompanist) (Latin word. *repetere*: to repeat), in music, an assistant conductor of an opera or ballet ensemble, who rehearses their parts, or accompanies or assists the soloists and the choir on the piano.

[3] Mikel Ndreca, Dictionaries of foreign words and expressions, Rilindja Edition 1986 pg. 430

[4] Po aty fq. 425

[5] Dictionary of Foreign Words: 1988 Renaissance Edition, Term **repetitive** = repetitum, repeat, repeater, repetitorium, (Latin word *repeater*) means repetition, repeat, etc.,.

[6] Teachers' work classified as *ex-ante* is calculated for the next period. Its calculation is based on returns or expected results. Therefore, the phrase expected result can also be used. The expected return is usually expressed based on the internal rate of return that students have from these learning activities.

[7] *Ex post* work is calculated for the previous period. Its calculation is based on realized returns. Therefore, with the phrase it can also be marked as a realized result.